

Të huajt në Shqipëri

Viti 2020

Tiranë, më 22 Dhjetor 2021: Në fund të vitit 2020, numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri rezultoi 13.609 banorë, duke pësuar rritje me 0,8 %, krahasuar me 2019.

Numri i të huajve rezidentë në 2020 dominohet nga meshkujt me 64,0 % kundrejt femrave me 36,0 %.

Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2020 ishte 7.661 aplikime, duke shënuar një rënie me 7,0 %, krahasuar me vitin 2019.


Të huajt rezidentë me origjinë nga Irani me 2.610, Italia me 2.067 dhe Turqia me 1.597, përbëjnë numrin më madh të të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri në 2020.

Të huajt me origjinë nga Evropa, në vitin 2020 rezultojnë 7.724 banorë dhe përbëjnë 56,8 % të të huajve gjithsej kundrejt 66,4 % që përbënin në 2019.

Arsyeja për punësim është arsyeja kryesore e lejeve të qëndrimit të të huajve në Shqipëri në 2020, me 47,5 %.

Në vitin 2020 janë evidentuar 18.835 të huaj të parregullt në territorin e vendit ku pjesën më të madhe të tyre prej 55,9 % e zënë të huajt me origjinë nga Iraku dhe Siria.

Fig. 1 Të huajt me leje qëndrimi sipas gjinisë, 2005-2020




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Për publikim 22 Dhjetor 2021

Të huajt në Shqipëri

Gjatë 2020 numri i të huajve rezident përbëhet nga 8.676 meshkuj dhe 4.933 femra. Meshkujt zënë 63,8 % në numrin e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri.

Fig. 2 Piramida e popullsisë së huaj rezidente në Shqipëri



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin


Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2020 është 7.661 aplikime, duke shënuar një rënie me 7,0 %, krahasuar me vitin 2019. Aplikimet sipas vendit të origjinës nga Irani dhe Italia përbëjnë 44,9 % të aplikimeve gjithsej, në 2020.

Tab. 1 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës 2019-2020

Vendi i origjinës	2019	2020
Iran	556	2.324
Itali	1.971	1.119
Kosove	1.104	916
Turqi	817	742
Greqi	205	139
SHBA	373	193
Kinë	241	80
Siri	310	177
Maqedonia e Veriut	148	120
Mbretëri e Bashkuar	180	163
Tjetër	2.467	1.688
Gjithsej	8.241	7.661

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Fig. 3 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas afatit të qëndrimit, 2020




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt në Shqipëri sipas kontinenteve

Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, në 2020 kryesohen nga vendet e Evropës, duke zënë 56,8 % të të huajve rezident gjithsej. Të huajt me origjinë nga Evropa janë 7.724, duke shënuar një rritje me 13,9 %, krahasuar me 2019. Të huajt me origjinë nga Azia janë 4.048, duke shënuar një rritje me 61,3 %, krahasuar me 2019. Të huajt me origjinë nga Amerika, Afrika dhe Oqeania janë 1.837, duke pësuar një rënie me 9,4 %, krahasuar me 2019.

Fig. 4 Të huajt me leje qëndrimi sipas kontinenteve, 2005-2020




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt në Shqipëri sipas arsyes

Në vitin 2020 të huajt rezident për arsye punësimi zënë 47,5 % të të huajve gjithsej, ndjekur nga arsyet për bashkim familjar me 24,5 %, arsyet për qëllime humanitare me 19,7 %, arsyet për studime 2,0 % dhe arsyet të tjera me 6,3 %.

Fig. 5 Të huajt me leje qëndrimi sipas arsyes, 2020



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Te të huajt rezident në Shqipëri me origjinë nga Italia, përveç arsyes për punësim (68,9 %) vihet re edhe një dominim i arsyes për bashkim familjar (18,3 %).


Të huajt me origjinë nga Turqia, kryesohen nga arsyet për punësim (65,2 %) dhe arsyet për bashkim familjar (32,3 %).

Të huajt me origjinë nga Kosova, kryesohen nga arsyet për bashkim familjar (41,7 %).

Të huajt me origjinë nga SHBA dhe Kina kryesisht dominohen nga arsyet për punësim (respektivisht me 67,5 % dhe 81,9 %).

Të huajt me origjinë nga Irani kryesisht dominohen nga arsye humanitare për të marrë leje qëndrimi në Shqipëri (98,8 %).

Fig. 6 Të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës dhe motivit, 2020




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt e parregullt

Të huajt e parregullt të evidentuar në territorin e Shqipërisë ose në kufi, pa dokumentacionin e nevojshëm, rezultojnë 18.835 persona në 2020, kundrejt 11.890 personave në 2019.


Fig. 7 Të huajt e parregullt, 2015-2020



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt e parregullt të kapur për herë të parë sipas vendit të origjinës në 2020, kryesohen nga vende si Siria me 6.224 persona, Afganistani me 1.893 persona, Maroku me 1.182 persona, Iraku 1.061 persona, 2.682 persona nga vende të tjera dhe 5.793 të huajt e parregullt përsëritës.

Fig. 8 Të huajt e parregullt sipas vendit të origjinës, 2018 - 2020



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor i të huajve në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmohave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi gjithashtu paraqet dhe të dhëna mbi të huajt e parregullt në territor.

Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Referuar të dhënave mbi aplikimet për leje qëndrimi dhe lejeve të qëndrimit në territor, informacioni sigurohet nëpërmjet Regjistrimit Elektronik për të Huajt (FER).

Lidhur me numrin e aplikimeve për leje qëndrimi gjatë një viti kalendarik, ju bëjmë me dije se numri i shtetasve Iranianë (grupimi MEK) në Shqipëri nuk ka ndryshim. Ky grupim rinovon lejet e qëndrimit sipas afateve të përfundimit të lejes ekzistuese. Kjo e dhënë bazuar në FER ndryshon nga viti në vit, në varësi të afateve të lejeve që do të rinovohen, zgjatjes së procedurës së vlerësimit etj., edhe pse numri i tyre në territor mund të jetë i njëjtë.

Përkufizime

I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.

Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.

Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me

vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundën objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Shërbimi vullnetar është një program aktivitësh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.

Studiues dhe specialistë janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.

Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.